REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA – VLADA – GOVERNMENT
MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SPORTIT

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË - MINISTAR SPORTA I OMLADINE - MINISTER OF SPORTS AND YOUTH
Nr. prot. 06 Shenja klas. 66
Nr.Pro/Viti 1042-2026-02
Data 28.08.2026
Nënshkrimi
Prishtinë

THIRRJE PËR APLIKIM

Për financimin e operimit vjetor dhe të performancës së organizatave sportive për vitin 2027

Në mbështetje të Rregullores (QRK) nr. 36/2024 për Procedurat dhe Kushtet e Financimit të Organizatave Sportive, Agjencia e Sportit, në kuadër të Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, shpall thirrjen për aplikim për financimin e operimit vjetor dhe të performancës së organizatave sportive për vitin 2027.

I. ORGANIZATAT SPORTIVE QË KANË TË DREJTË APLIKIMI

- Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK), Olimpiada Speciale kanë të drejtë të aplikojnë për financim të operimit vjetor, në përputhje me Rregulloren.
- Federatat sportive, federatat parasportive, federatat shumësportive dhe shoqatat sportive të punëtorëve kanë të drejtë të aplikojnë për financim të operimit vjetor dhe financim për performancë, në përputhje me Rregulloren.
- Të drejtë aplikimi kanë federatat sportive, federatat parasportive, federatat shumësportive dhe shoqatat sportive të punëtorëve që posedojnë licencë të lëshuar nga Ministria e Sportit dhe Rinisë.

II. FORMAT E FINANCIMIT

1. Financimi për operim vjetor – për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative të organizatës sportive;
2. Financimi për performancë – bazuar në arritjet, rezultatet dhe aktivitetet e realizuara gjatë periudhës së vlerësimit, sipas kritereve dhe nënkritereve të përcaktuara nga Agjencia e Sportit.

III. PERIUDHA E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

Në përputhje me nenin 7 paragrafin 4 të Rregullores, për aplikimin e vitit 2027 vlerësohen arritjet, rezultatet dhe aktivitetet e realizuara gjatë periudhës nga 1 shtator 2025 deri më 1 shtator 2026.

Për arritjet rezultatet dhe aktivitetet e realizuara gjatë periudhës nga 1 shtator deri më 31 dhjetor 2025, aplikuesi duhet të deklarojë nëse të njëjtat janë paraqitur dhe vlerësuar në procedurën paraprake të financimit.

Arritjet, rezultatet dhe aktivitetet që janë paraqitur dhe janë marrë parasysh gjatë vlerësimit paraprak nuk i nënshtrohen pikëzimit të përsëritur. Për vlerësim mund të paraqiten vetëm ato që nuk janë vlerësuar më parë dhe që dëshmohen me dokumentacionin përkatës.

IV. DOKUMENTET PËR KOK, KPK, OLIMPIADËN SPECIALE

Komiteti Olimpik i Kosovës, Komiteti Paralimpik i Kosovës dhe Olimpiada Speciale duhet të dorëzojnë:

1. Formularin e përgjithshëm të aplikimit;
2. Propozimin për financim, i cili përmban koston e shpenzimeve bazë për operim vjetor dhe përgatitet sipas formularit dhe udhëzuesit të miratuar nga Agjencia e Sportit;
3. Duhet të jenë të mbyllura apo ne proces te mbylljes të gjitha shpenzimet dhe raportet financiare për periudhat paraprake të financuara nga buxheti i Ministrisë.
4. Raportin e auditimit financiar të organizatës për vitin paraprak.

V. DOKUMENTET PËR FEDERATAT SPORTIVE, FEDERATAT PARASPORTIVE

Federatat Sportive duhet të dorëzojnë:

1. Formularin e përgjithshëm të aplikimit;
2. Formularin dhe buxhetin e propozuar për financimin e operimit vjetor
3. Formularin për financim të performancës, së bashku me dokumentet që dëshmojnë përmbushjen e kritereve dhe nënkritereve përkatëse;
4. Duhet të jenë të mbyllura apo ne proces te mbylljes të gjitha shpenzimet dhe raportet financiare për periudhat paraprake të financuara nga buxheti i Ministrisë.
5. Dokumentet dhe deklaratat e tjera të përcaktuara në formularët dhe udhëzuesit përkatës.

VI. MËNYRA E DORËZIMIT dhe AFATI I APLIKIMIT

Aplikimi dorëzohet në formë fizike në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, nga data e publikimit të thirrjes deri më 30 shtator 2026.

VII. DOKUMENTET E THIRRJES

Pjesë përbërëse të kësaj thirrjeje janë: udhëzuesit për aplikim, formulari i përgjithshëm i aplikimit, formulari për financim të performancës, formulari për financim të operimit vjetor, si dhe lista e kritereve, nënkritereve dhe dokumenteve dëshmuese.